



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 13.08.2026
Zyrtarët përgjegjës:		VI-020-236/19
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale	
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02Nr.400/01-31289 për shfuqizimin e vendimeve 02Nr.462/01-11324, 02Nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit
I miratuar më datë: 30.07.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.07.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2026, ka miratuar Vendimin 02Nr.400/01-31289 për shfuqizimin e vendimeve 02Nr.462/01-11324, 02Nr.462/01-19811 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, është bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), nenit 34 të Statutit të Komunës së Glllogocit, si dhe bazuar në nenin 53 dhe 57 paragrafi 1 si dhe nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 të procedurës së përgjithshme administrative, si dhe në bazë të shkresës së MAPL-së së datës 12.05.2026.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e mbajtur të datës 30.07.2026, me 22 vota për, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci , gradonačelnik opštine Glogovac Burim Bujupi , predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi , ministar MALS-a, Jeton Qela , generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi , rukovodioc Pravnog odeljenja / MALS	Dana 13.08.2026 VI-020-236/19
Odgovorni službenici:		
1. Službenik/ca za potvrđivanje procene:	za pravne razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika	
2. Službenik/ca za izradu pravne ocene	Vjosa Ahmetaj , viša službenica za razmatranje zakonitosti opštinskih akata	
Predmet:	Potvrda zakonitosti	
Vrsta odluke:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelniče/e,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom (VRK) br. 03/2026, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026, o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kao u nastavku:

Odluka 02 br.400/01-31289 o stavljanju van snage Odluka 02br.462/01-11324, 02br.462/01-19811 o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine u trajanju od 35 godina putem postupka pregovora
Usvojena dana, 30.07.2026.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 31.07.2026.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština Opštine Glogovac je na sednici održanoj dana, 30.07.2026.godine, odobrila Odluku 02 br.400/01-31289 o stavljanju van snage Odluka 02br.462/01-11324, 02br.462/01-19811 o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine u trajanju od 35 godina putem postupka pregovora.

MALS konstatuje da usvojena odluka od strane Skupštine opštine Glogovac, zasnovana na članovima 11, 12. i 40. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, „Službeni list Republike Kosovo) na članu 34 Statuta opštine Glogovac, i na osnovu članova 53. i 57. stav 1 i članu 48. Zakona br. 05/L-031 o opštem upravnom postupku, kao i na osnovu pisma MALS-a od 12.05.2026.godine.

Odluka je usvojen na sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 30.07.2026. godine, sa 22 glasova za, 0 protiv i 1 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glogoc)
Kuvendi i Komunës

02Nr.462/01-31289 dt. 30/07 2026

PRITJESE - ULAZNA - INCOMING		
KOMUNA E DRENASIT (GLOGOC) - REPUBLIKA E KOSOVES		
KOMUNITETI I Administrimit të Pushtetit Lokal		
Local Government Administration		
Data: 31.07.2026		
Orari: 14:00		
Vendi: Vlera		
-46- 420-234/19		



Bazuar në nenin 11, 12, 40 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës si dhe bazuar në nenin 53 dhe 57 paragrafi 1 si dhe neni 48 të Ligjit Nr. 05/L -031 Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në bazë të shkresës së MAPL-së dt: 12.05.2026 Kuvendi i Komunës së Drenasit sipas propozimit të anëtarëve të kuvendit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për shfuqizimin e Vendimeve 02nr.462/01-11324, 02Nr.462/01-19811 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negociimit

Neni 1

Shfuqizohet Vendimi 02nr.462/01-11324 i datës 30.03.2026 si dhe Vendimi 02Nr.462/01-19811 i datës 29.05.2026 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negociimit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Gjeodezi, kadastër dhe pronë.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga data e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës dhe i njëjti do të prodhoj pasoja juridike deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Zyrës së Kuvendit;
- Drejtorisë përkatëse;
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Burim Bujupi

ARSYETIM

Komuna e Drenasit përmes Vendimeve 02Nr.462/01-11324 të datës 30.03.2026 është miratuar dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit, të ofertës të cilat vendime Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes akteve të saj nr.-VI-020-236/12 të datës 12.05.2026 si dhe si dhe shkresë me -VI-020-236/12 të datës 26.06.2026 dhe pas rekomandimeve të dhëna nga MAPL Kuvendi Komunal ka nxjerr 02Nr.462/01-19811, andaj me qëllim të respektimit të parimit të ligjshmërisë dhe sigurimit të përputhshmërisë së veprimtarisë së Komunës me legjislacionin në fuqi Kuvendi I komunës propozon shfuqizimin e Vendimeve të lartcekura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 462/01-498/11 dt. 04/06/2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ofertës Nr.01-070/01-6692 të datës 20.02.2026, Procesverbalit Nr.01-060/04-9412 të datës 12.03.2026 si dhe shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit me nr. të protokollit 020-236/9 të datës 12.05.2026, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës

Neni 1

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të datës: 29.05.2026 aprovoi që në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosje, pas eliminimit të të metave të evidentuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit me nr. të protokollit 020-236/9 të datës 12.05.2026 të miratoj dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës.

Neni 2

1. Me këtë vendim, miratohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, prona e paluajtshme e Komunës, kompanisë "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k", me numër unik identifikues 812036425, të cilën e përfaqëson Iflach Ben Shlomo, me procedurën e negocimit të ofertës.
2. Prona e paluajtshme që propozohet për dhënie në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim është në:
 - o Sipërfaqja prej 130000 m² nga parcela P-70315035-00848-0, në Krajkovë, të parapara nga HZK, kapaciteti 9.99 MW vlerë investive 5.800.000,00 €;
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës sipas pikës 1 të këtij vendimi është: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushja e interesit të përgjithshëm të qytetareve.

3.1 Në ofertën e negociuar "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k", planifikon investim në realizimin e projektit me kapacitet prej 9.90 MW, projekt i energjisë së ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike me panele solare.

4. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë në mes të kryetarit të komunës dhe kompanisë "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k".

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 02 Nr.462/01-I 1324 të datës 30.03.2026 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronën e paluajitshme të komunës me procedurë të negociimit të ofertës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka filluar procedurat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës si rrjedhojë e të cilit proces është edhe miratimi i të njëjtës ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi të votohet ky propozim vendim.

Një propozim vendim i tillë vije gjithashtu duke u bazuar në shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit me nr. të protokollit 020-236/9 të datës 12.05.2026, e cila ndër të tjera potencon se Komuna e Drenasit duhet të bëjë edhe njëherë rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit pasi që dokumenti në fjalë nuk është në harmoni me nën-paragrafin 6.6 të paragrafit 6 të nenit 23 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, konkretisht në rastin konkret qarkullimi bankar për vitin paraprak të biznesit nuk përputhet me emrin e kompanisë përfutuese e cila përmes procedurave të negocimit do të marrë në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të komunës, të cilat të meta konsiderojmë se veç se janë të eliminuara dhe akti në fjalë përmes këtij propozim vendimi paraqitet para kuvendit komunal për miratim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Poshetit Lokal
Ministria e Administrimit të Poshetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 26.06.2026

Arnim Zuka, Udhëvëdhës i Përgjithshëm Shtetëror - Avokat i Shtetit -
Ministria e Drejtësisë

Lënda: Shkresat përfaqëse

Udhëzues,

Ministria e Administrimit të Poshetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, Vendimin 02Nr.462/01-11324 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, i miratuar me 30.03.2026 nga Kuvendi i Komunës së Gillogocit.

Me datë 12.05.2026, MAPL, ka dërguar në Komunën e Gillogocit kërkesën për rishqyrtimin e aktit.

Duke punuar për bazë në Kuvendi i Komunës së Gillogocit, konform nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka ndërmarr veprimet duke rishqyrtuar aktin në Kuvendin e Komunës së Gillogocit me datë 29.05.2026, por akti nuk është harmonizuar me legjislacionin në fuqi, konform kërkesës së MAPL-së për harmonizim të aktit, Ministria e Administrimit të Poshetit Lokal, konform nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dërgoi Vendimin 02Nr.462/01-11324 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për parcelën P-70315035-00848-0, i miratuar me 30.03.2026 nga Kuvendi i Komunës së Gillogocit, në gjykatën kompetente për të vendosur lidhur me këtë çështje.

Ministria e Administrimit të Poshetit Lokal, në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrave, vlerëson se Ministria e Drejtësisë - Avokati i Përgjithshëm Shtetëror është kompetent të dërgoj lëndën në gjykatë.

Bazuar në këtë, bashkëngjitur gjenti lëndën e kompletuar lidhur me këtë çështje.

Me respekt,

Jeton Qela
Sekretar i Përgjithshëm, MAPL.

Kopje: Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
Kryetari i Komunës së Gillogocit,
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gillogocit,
Arkivat të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02Nr.462/04-A/32L dt. 30/03/2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 11, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 23, paragrafi 7, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ofertës nr. 01-070/01-6692 dt. 20.02.2026, si dhe Procesverbalit nr. 01-060/04-9412 të dt. 12.03.2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës

1. Me këtë vendim, miratohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronë e paluajtshme e Komunës, kompanisë "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k", me numër unik identifikues 812036425, të cilën e përfaqëson Ilach Ben Shlomo, me procedurën e negociimit të ofertës.
2. Prona e paluajtshme që u miratua për dhënie në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim është në:
 - o Sipërfaqja prej 130000 m² nga parcela P-70315035-00848-0, në Krajkovë, të parapara nga HZK, kapaciteti 9.99 MW vlera investive 5.800.000,00 €;
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës sipas pikës 1 të këtij vendimi është: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushja e interesit të përgjithshëm të qytetarëve.
- 3.1 Në ofertën e negociuar "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k", planifikon investim në realizimin e projektit me kapacitet prej 9.90 MW, projekti i energjisë së ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike me panele solare.
4. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë në mes të kryetarit të komunës dhe kompanisë "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k".
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga data e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në libërfaqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:


- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



ARSYETIM

Kompania "TDI Kosovo Holdings Sh.p.k" SHPK me datë 20.02.2026, ka dorëzuar ofertën Nr. 01-070/01-6692, Komunës së Drenasit, respektivisht Kryetarit të Komunës, për marrje në shfrytëzim të pronës së komunës përmes Negocimit.

Kryetari i komunës me datë 12.03.2026 sipas procesverbalit Nr. 01-060/04-9412 negocion ofertën e kompanisë, ndërsa përmes këtij propozim-vendimi i propozon kuvendit të komunës që duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm dhe zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit të votohet ky propozim-vendim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Gillogocit
Kopje:	Burim Buçupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gillogocit
Përmes:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Nga:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari i Konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari i hartues i vlerësimit ligjor
Lënda:	Xhevat Tafu, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale
Lloji i aktit:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit Vendim i Kuvendit të Komunës së Gillogocit

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Pushtat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02/Nr.462/01-11324 për dhënien në shërbëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për parcelën P-70315035-00840-0
I miratuar më datë: 30.03.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.03.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislatonit në fuqi.

Arsyetimi

Kuvendi i Komunës së Gillogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2026, ka miratuar Vendimin 02Nr.462/01-11324 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-/0315035-00848-0.

Vendimi 02Nr.462/01-11324 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negocimit të ofertës për parcelën P-/0315035-00848-0, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi përkatësisht me nën paragrafin 6.6 të paragrafit 6 të nenit 23, të Rregullores (ORIK) Nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sipas të cilit: Pas negocimit të ofertës, kryetari i komunës i propozon kuvendit të komunës të miratojë vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke i bashkangjitur dokumentet përçjellëse, si: "Certifikatën e regjistrimit të biznesit, vërtetimin që nuk ka obligime tatimore, qarkullimi bankar për vitin paraprak".

Në rastin konkret qarkullimi bankar për vitin paraprak i biznesit, nuk përputhet me emrin e kompanisë përfituese, e cila përmes procedurës së negocimit do të marrë në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të komunës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Gillogocit duhet të ndërmerë veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtojë dhe të harmonizojë aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të nevojshëm në lidhje me këtë vlerësim.